



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Raport gjashtëmujor për procesin e konsultimit publik të realizuar nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

1. Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka konsultuar dhe miratuar projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”, i cili është objekt i ligjit nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Për konsultimin e këtij akti është zbatuar parimi proaktiv për nxitjen e pjesmarrjes së palëve të interesit në konsultim që në fazën fillestare të hartimit. Konsultimi është paraprirë me takime individuale dhe në grup me përfaqësues të ndryshëm të ekosistemit të *startup*-eve, përgjatë katër mujorit të tretë të vitit 2022 dhe përgjatë muajve janar-shkurt 2023

Draft akti ka qëndruar në Regjistrin Elektronik të Konsultimit Publik për periudhën kalendarike nga data 17.03.2023 deri më 14.04.2023. Rezulton se publikimi ka patur 396 shikime dhe nuk ka patur kontribute apo komente të depozituar përgjatë kësaj periudhe.

MiSHMS nuk ka miratuar akte për konsultim publik përgjatë vitit 2022, megjithatë mësimet e nxjerra nga ky proces lidhen me nxitjen e reagueshmërisë dhe përfshirjes së publikut në proces duke përfituar nga platforma online e konsultimit publik.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

MiSHMS për periudhën Janar-Qershor 2023 ka propozuar vetëm 1 (një) projektakt të miratuar. Bëhet fjalë për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”.

2.1.2. *Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?*

MiSHMS për periudhën Janar-Qershor 2023 ka konsultuar 1 (një) projektakt dhe nuk ka akt të pakonsultuar.

2.1.3. *Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?*

MiSHMS për periudhën Janar-Qershor 2023 ka konsultuar 1 (një) projektakt me Raport të vlerësimit të ndikimit rregullator.

2.1.4. *Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?*

- a) Asnjë.
- b) Asnjë.
- c) Asnjë.

2.1.5. *Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?*
1 (një) projektligj.

2.1.6. *A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?*
Nuk ka zhvillim për t’u përmendur.

2.2. Metodat e konsultimit

2.2.1. *Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

- a. Regjistri Elektronik;
- b. Takime paraprake me grupe interesi;
- c. Asistence teknike nga institucione të huaja
- d. Takime konsultative me përfaqësues institucionesh.
- e. Takime me komunitetin akademik dhe kërkimit shkencor
- f. Mbledhje të këshillit konsultativ

2.2.2. *Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Takime të mbyllura me grupe interesi.

2.2.3. *A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

MiSHMS për periudhën Janar-Qershor 2023 ka zhvilluar konsultime për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve".

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. *Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve" ka qendruar për konsultim publik për 20 ditë.

2.3.2. *Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

4 (katër) muaj.

2.3.3. *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Nuk ka zhvillim për t'u përmendur.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 *Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?*

1 ekspert i asistencës nga GIZ si zbatues i projektit EU for Innovation.

2.4.2 *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Asistenca nga përfaqësues të GIZ si zbatues i projektit EU for Innovation.

2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Aktorë nga ekosistemi dhe përfaqësues së institucioneve.

i. Aktorë të ekosistemit, 10 përfaqësues;

- përfitues nga Thirrja e Parë për masa mbështetëse, punonjës lëvizës digjitalë, donatorë dhe organizata jo qeveritare me fushë veprimtarie ekosistemin e startup-eve.
- ii. Njësitë e Qeverisjes Vendore, 5 përfaqësues;
 - përfaqësues të Bashkive përfituese nga mbështetja me grant.
- iii. Institucione shtetërore, 3 përfaqësues;
 - SASPAC, AKSHI dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- iv. Përfaqësues të akademisë, 12 përfaqësues;
 - Përfaqësues nga institucionet akademike dhe profesionistë të kërkimit shkencor.

2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

- Punonjës lëvizës digjitalë, që aktualisht veprojnë në Shqipëri
- Përfaqësues të startup-eve në fazën e idesë.
- Përfaqësues së institucioneve dhe të ekosistemit të startup-eve.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Evidentohet një proces efektiv konsultimi publik për aktin e miratuar.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup-eve*” kanë mbërritur 3 (tre) komente.

2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Nga totali, të 3 (tre) komentet u pranuan.

2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Nuk ka zhvillim për t’u përmendur.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Asnjë.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

MiSHMS për periudhën Janar-Qershor 2023 ka publikuar 1 (një) raport konsultimi.

2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

Nuk aplikohet.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

8 (tetë) pikë.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (*Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?*)

Sfida dhe mundësitë për përmirësim në të ardhmen janë rritja e gjithëpërfshirjes së aktorëve për nga numri dhe kategoritë në procesin e konsultimit.